



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## VENDIM

**Nr. 66, datë 12.06. 2020**

### **“PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMUNITARE TË TERRENIT”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “ç”, nenit 24, nenit 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 5, shkronja “d”, të Ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenit 7, pika 4, të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2016, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, pikës 17, të Vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I :**

- 1.** Krijimin e Qendrës Komunitare të Terrenit në vijim, “Qendra”, si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.
- 2.** Qendra ka këto funksione dhe përgjegjësi:
  - a.** identifikimin e individëve (fëmijë dhe të rritur) në situatë rruge dhe referimin e tyre pranë strukturave menaxhuese dhe të shërbimit;
  - b.** vlerësimin të shpejtë të nevojave bazë të individit;
  - c.** shërbime këshilluese, ndërmjetësuese lidhur me strehim social, punësimin dhe aspektet ligjore;
  - ç.** shoqërimin e rasteve të identifikuara në nevojë për mbrojtje të menjëhershme në struktura, si komisariate, institucione shëndetësore apo të kujdesit etj;
  - d.** sensibilizim të qytetarëve mbi risqet e situatës në rrugë dhe stimulimit të saj;
  - dh.** trajnime, workshope, takime me individë, prindër dhe anëtarë të komunitetit për rritjen e kapacitetit të tyre në fushat e mirëqenies sociale;
  - e.** vizita në familje;

ë. advokaci dhe lobim;

f. si dhe çdo detyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ose të ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë, që lidhen me funksionet e lartpërmendura.

3. Qendra do të funksionojme turne, 24 orë në 7 ditë, me një numër total prej 20 (njëzet) punonjësish.

4. Qendra drejtohet nga Drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e Qendrës. Punonjësit e tjerë emërohen dhe lirohen nga detyra, në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

5. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Qendrës, sipas lidhjes nr. 9, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë, për vitin 2020, duke reflektuar shtesat dhe pakësimet brenda programit të Planifikim, Menaxhim, Administrim dhe Kujdes Social për Familjet dhe Fëmijët sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Ngarkohet kryetari i Bashkisë të miratojë strukturën organizative dhe rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Qendrës Komunitare të Terrenit, si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni.

8. Bashkia Tiranë i siguron Qendrës mjediset e nevojshme, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambiente të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së saj.

9. Në rastin e sigurimit të pasurive në administrim të Bashkisë Tiranë, ngarkohet Kryetari i Bashkisë për ndjekjen e procedurave të dorëzimit dhe kalimit kapital të pasurive, objekt i ushtrimit të detyrave funksionale, sipas të këtij vendimi dhe akteve të dala në zbatim të tij.

10. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Qendra Komunitare e Terrenit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**